



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1702/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ.Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, R me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.*
- II.** Riakreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Farmacë MPh 300 ECTS, R me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
 - *Politika Publike dhe Menaxhment MA 120 ECTS R, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik.*
- III.** Akreditohen programet e studimit të Kolegjit UBT kampusi kryesor për periudhën **tre (3) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
 - *Inxhinieri e Energjisë BSc 180 ECTS, A me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik*
 - *Gjuhë, Media dhe Komunikim MA 120 ECTS, A me kuotën maksimumi 30 studentë për vit akademik.*
 - *Turizëm BSc 180 ECTS A me kuotën maksimumi 70 studentë për vit akademik.*
- IV.** Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI.** Obligohet Kolegji UBT kampusi kryesor të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovohet me vendim nga KShC.

VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji UBT kampusi kryesor brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditim dhe riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1.	<i>Gjuhë Angleze BA 180 ECTS, R</i>	Alma Lama Donjete Latifaj Luize Zeqiri
2.	<i>Farmacë MPh 300 ECTS, R</i>	Demush Bajraktari Fitim Alidema Bujar Qazimi Shpend Dragusha Valon Ejupi
3.	<i>Politika Publike dhe Menaxhment MA 120 ECTS, R</i>	Shqipe Mjekiqi Llokman Mirtezani
4.	<i>Inxhinieri e Energjisë BSc 180 ECTS, A</i>	Agron Bislimi Marigona Krasniqi Nexhmi Krasniqi Kadri Kadriu
5.	<i>Gjuhë, Media dhe Komunikim MA 120 ECTS, A</i>	Ferid Selimi Kadri Krasniqi
6.	<i>Turizëm BSc 180 ECTS A</i>	Kushtrim Dreshaj Fatmire Shala Dreshaj Sali Krasniqi Alban Fejza

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Kolegjin UBT kampusi kryesor, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë në përbërje: *Antonio Sanchez Pozo, Sabri Nibal, Jakob Patekar, Andrew Goodspeed, Christopher Bohlens, Taumo Otto, Matej Drobnic, Andreas Mehrle, Majda Tafra, Katerina Klimoska, Kristijan Kotarski, Alen Host, Mustafa Kayyali, Olgun Cicek dhe Lali Giorgitze.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. **Për programin e studimit; Gjuhë Angleze BA 180 ECTS**, më 18.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6), Substancialisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
2. **Për programin e studimit; Farmaci MPh 300 ECTS**, më 31.05.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), Substancialisht katër (4) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit.
3. **Për programin e studimit; Politika Publike dhe Menaxhment MA 120 ECTS R**, më 26.07.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit: *Katerina Klimoska, Kristijan Kotarski, Alen Host dhe Mustafa Kayyali*, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) kurse Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
4. **Për programin e studimit; Inxhinieri e Energjisë BSc 180 ECTS**, më 19.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2) kurse Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit.
5. **Për programin e studimit; Gjuhë, Media dhe Komunikim MA 120 ECTS**, më 19.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht shtatë (7) fusha të standardeve të akreditimit.
6. **Për programin e studimit; Turizëm BSc 180 ECTS A**, më 28.06.2024 është organizuar vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht tre (3) kurse Substancialisht tre (3) dhe Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127 të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit UBT kampusi kryesor dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi i dërgohet:

- Kolegjit UBT kampusi kryesor;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë